


2.6 PRODUKTE SHITESË PËR TRAJTIMIN E FUGAVE

FLEX PU 40



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi
600 ml/tubet	12 copë/kuti	0.2-2 kg/m ²



FLEX PU - 40

Silikon me bazë poliuretani

KARAKTERISTIKAT

Mastikë elastik fugash, një përbërës, me bazë poliuretani. Është mekanikisht rezistent, nuk vajoset dhe reziston në diell dhe në dëborë. Nuk ndikohet nga uji i kripur ose jo, lyhet dhe është rezultativ për vulosje fugash me gjerësi 6 - 30 mm dhe thellësi 3 - 15 mm.

APLIKIMI

FLEX PU - 40 ofrohet për vulosje elastike të pretendimeve të larta, në zbatime të shumta:

- Mbulim fugash bymimi në ndërtesa, koridore aeroporti, lidhje tubash çimento kanalizimesh, mure parafabrikat prej betoni.
- Vulosje fugash kasash dritarësh, dyersh, prej alumini, metalike, druri dhe PVC.
- Hidroizolim perimetrik ndërtesash në bashkimin e sipërfaqeve të jashtme horizontale me ato vertikale.
- Mbrojtje të ngjitjes dhe të vulosjes gjatë vendosjes së pllakave, sa tek mbushja e fugave bymyese, në sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme, aq edhe në mbushjen e fugave perimetrike tek përfundimet e pllakave të dyshemesë me muret ose parmakët si edhe në ballkone para mbulimit me parvaze.
- Vulosje kangjellash metalike dhe druri në vëndet e bashkimit të tyre me mermerët, gurë natyral ose beton në tarraca, ballkone, mure.
- Punime në ndërtim anijesh për çdo vulosje elastike ose fiksion poliestere me dru, inoks ose alumini.

MËNYRA E PËRDORIMIT

1. Përgatitja e sipërfaqes

Nënshtresa të jetë e qëndrueshme, e thatë dhe e çliruar nga vajra. Në sipërfaqe prej betoni ose suva, largojmë nga anët e fugave materialet e kalbura dhe pluhurat me furçë teli dhe fshesë thithëse ose me ajër presioni dhe penel. Thëllësia e fugës përcaktohet në gjysmën e gjerësisë së saj dhe regullohet me kordon mbushës fugash prej polietilen të fryrë

dhe në qoftë se nuk ekziston, me polisterin të fryrë. Përdorimi i letrës ngjitëse në kufitë e fugës lehtëson në përcaktimin e saktë të vijës vulosëse. Për puthitje më të mirë dhe ngjitje të pathyeshme të FLEXPU-40.

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

Ruhet në vënde të thata dhe nën hije të paktën 12 muaj nga data e prodhimit.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Baza Poliuretani	
Forma - Ngjyra	Gri
Temperatura e zbatimit	Nga +5°C deri +30°C
Termorezistenca	Nga - 30°C deri +80°C
Pesha specifike	1,15 - 1,19 gr/ml
Kohë krijimi membrane sipërfaqësore	15 - 20 minuta
Mundësia e deformimit të nyjes	25%

